

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Agim Maliqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit J.B., nga fshati O., komuna e Gj., për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga i dënuari kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, P.nr.96/2016 datë 11.9.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Pn.nr.855/2017 datë 23.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 26 mars 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit J.B., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, P.nr.96/2016 datë 11.9.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Pn.nr.855/2017 datë 23.10.2017.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore Gjakovë, P.nr.96/2016 datë 11.9.2017, është refuzuar kërkesa e të dënuarit J.B., për kthim në gjendjen e mëparshme, ndërsa sipas pikës II të dispozitivit është hedhur kundërshtimi si i pasafatshëm, i ushtruar kundër aktgjykimit për dhënien e urdhrit ndëshkimor P.nr.95/2016 datë 15.5.2017.

Duke vendosur sipas ankesës së të dënuarit, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktvendimin Pn.nr.855/2017 datë 23.10.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të dënuarit të paraqitur kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, i dënuari J.B., ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që aktvendimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr.235/2017 datë 15.12.2017, ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën e ushtruar, i dënuari potencon se aktvendimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse në rastin konkret janë shkelur dispozitat ligjore lidhur me dorëzimin e vendimit gjyqësor. Thekson se aktgjykimi mbi dhënien e urdhrit ndëshkimor nuk i është dorëzuar dhe kjo ka qenë arsye përse ai ka lëshuar afatin për ushtrimin e kundërshtimit kundër aktgjykimit në fjalë. Thekson se pasi që ka kuptuar nga një punëtore e gjykatës për këtë, i është drejtuar gjykatës me një kërkesë që t'i dorëzohet aktgjykimi në fjalë. Më pas ka paraqitur edhe kundërshtimin, i cili nga gjykata, është hedhur si i pasafatshëm. I dënuari po ashtu potencon se ai nuk e ka nënshkruar fletë dorëzimin mbi pranimin e vendimit. Përveç kërkesës, i dënuari ka paraqitur edhe dy parashtresa si plotësim të kërkesës dhe atë më datë 5.1.2018 dhe më 17.1.2018, me ç'rast ka bashkangjitur edhe ca dokumente respektivisht një raport i Postës së Kosovës nr. 05-106/18 datë 15.1.2018 dhe deklaratën e noterizuar të postierit-personit zyrtar i cili kishte dorëzuar shkresën në shtëpinë e të dënuarit.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson si të pabazuara pretendimet e mësipërme nga këto arsye.

Siç rezulton nga shkresat e çështjes, i dënuari J.B., me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjakovë mbi dhënien e urdhrit ndëshkimor P.nr.95/2016 datë 15.5.2017, është shpallur fajtor për veprën penale kanosje nga neni 185 par. 2 të KPK dhe është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 200 €, të cilën është i obliguar që të paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e në rast të mos pagesës i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditësh duke llogaritur 20 € në një ditë burgim.

Nga shkresat e çështjes rezulton se i dënuari J.B., aktgjykimin e shkallës së parë e ka pranuar me rregull meqë në shkresat e çështjes ekziston fletë kthesa e datës 30.5.2017 e cila është nënshkruar nga marrësi dhe dorëzuesi i shkresës. Kjo

Gjykatë vlerëson se në rastin konkret dorëzimi i aktgjykimit (shkresës) është bërë në përputhje me dispozitën e nenit 447 par.1 të KPPK dhe ky dorëzim konsiderohet valid. Nga shkresat e çështjes po ashtu rezulton se kundër këtij aktgjykimi, i dënuari kundërshtimin e ka paraqitur më 28.8.2017, pra 2 (dy) muaj e 28 (njëzet e tetë) ditë pas skadimit të afatit, ndërsa afati ligjor për ushtrimin e kundërshtimit është 8 (tetë) ditë.

Nga arsyet e lartcekura, kjo Gjykatë vlerëson si të pabazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë sepse drejt kanë konkluduar të dy gjykatat se kundërshtimi në fjalë ka qenë i pasafatshëm, kjo nga fakti se nga shkresat e çështjes më pa mëdyshje rezulton se dorëzimi i shkresës ka qenë i rregullt për çfarë të dy gjykatat në vendimet e tyre, kanë dhënë arsye të qarta dhe ligjore, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë.

Për më tepër, vlen të theksohet se provat të cilat i dënuari i ka bashkangjitur kërkesës veç sa shkojnë në favor të konstatimit të gjykatës lidhur me rregullsinë e dorëzimit të shkresës, meqë nga ky dokumentacion rezulton se dërgesa është dorëzuar në destinacion-në shtëpinë e të dënuarit, të cilën e ka pranuar një anëtar i familjes. Po ashtu, nga ky dokument-deklarata e personit zyrtar-postierit, rezulton se dërgesat në këtë shtëpi zakonisht i pranojnë i dënuari ose bashkëshortja e tij.

Nga sa u tha më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u refuzua si e pa bazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr. 352/2017, më 26 mars 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta